



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 36/11

Prishtinë, më 25.11.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Ramadan Avdiu, zv. Ministër i Financave, Agim Krasniqi Drejtor i Departamentit të Buxhetit të MF, Selman Imeri, Drita Hasani dhe Islam Caka nga Ministria e Punëve të Brendshme, Rejhane Zylfijaj, Njomza Ilazi, Juergen Schatz dhe Ramadan Islami-GIZ, monitorues nga OSCE, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Aurora Ademi dhe Njomza Halilaj (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj – Kryetare e komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit më datën 09.11.2011 dhe 16.11.2011;
3. Shqyrtimi i kërkesës për transferin e mjeteve buxhetore nga Ministria e Punëve të Jashtme në Ministrinë e Integrimeve Evropiane;
I ftuar: Agim Krasniqi – Drejtor i Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-69 për të Huajt, me raportin me amendamente të komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-73 për Azilin me raportin me amendamente të komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së;
6. Shqyrtimi i Propozim Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012;

7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit më datën 09.11.2011 dhe 16.11.2011

Procesverbalet miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës për transferin e mjeteve buxhetore nga Ministria e Punëve të Jashtme në Ministrinë e Integritetit Evropiane

Kryetarja, sqaroi se kërkesa përfshin shumën prej 500.000 € për transfer në Ministrinë e Integritetit Evropiane, konkretisht 300.000 € të kalojnë në kategorinë e shpenzimeve komunale dhe 200.000 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Arsyeja për një transferim të tillë është intensifikimi i punëve të Ministrisë së Integritetit Evropiane në agjendën e saj evropiane, sidomos në përsheptimin e proceseve integruese dhe intensifikimin e komunikimit dhe informimit në mediat evropiane. Me ligj lejohet transferimi i mjeteve buxhetore, mirëpo, meqenëse jemi në fund të muajit Nëntor nuk dihet se sa do të ketë efekt një transferim i tillë.

Agim Krasniqi, theksoi që kjo kërkesë është aprovuar nga Ministria e Financave, mirëpo duhet paraprakisht edhe miratimi nga Kuvendi, sidomos kjo kërkesë është e dobishme tani në këtë kohë kur kemi të bëjmë me Raportin e Progresit dhe përmbushjen e disa kriterëve nga Ministria e Integritetit Evropiane. Njoftoi anëtarët e komisionit që sot mbyllën zotimet për mallra dhe shërbime në bazë të udhëzimit për mbyllje të vitit fiskal, mirëpo në raste të veçanta siç është rasti me këto dy ministri, në qoftë se Kuvendi e miraton kërkesën, Ministri ka të drejtë që edhe pas datës 25 Nëntor të lejojë zotime në përgjithësi për agjencionet buxhetore.

Xhevdet Neziraj, theksoi që është e pakuptimtë që në fund të vitit të paraqitet një kërkesë e tillë dhe kjo është si rezultat i një planifikimi jo të mirë nga ana e agjencioneve buxhetore.

Naser Osmani, theksoi që nga ana procedurale është e drejtë që komisioni t'ia paraqesë Kuvendit rekomandimin për miratimin e kërkesës, mirëpo çështja qëndron se si do të zhvillohet kjo në dinamikë. Kjo nuk është diçka urgjente, sepse, më tepër ka të bëjë me faktin që raportet e shpenzimeve të dalin më të mira në fund të vitit dhe konsideroi që nuk duhet të aprovohet një kërkesë e tillë.

Latif Gashi, kërkoi sqarim më të arsyeshëm nga Ministria e Financave dhe propozoi që të ftohen edhe përfaqësues nga të dyja ministrinë, në mënyrë që të analizohet në detaje kjo kërkesë.

Komisioni me shtatë vota për (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj dhe Muhamet Mustafa), dy kundër (Naser Osmani dhe Xhevdet Neziraj) dhe një abstenim (Hykmete Bajrami) nxorri këtë:

PËRFUNDIM

I. Kërkesa për transferin e mjeteve buxhetore nga Ministria e Punëve të Jashtme në Ministrinë e Integritimit Evropian, shtyhet për shqyrtim në një mbledhje tjetër të Komisionit, ku do të ftohen përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Integritimit Evropian.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-69 për të Huajt, me raportin me amendamente të komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-73 për Azilin me raportin me amendamente të komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyerje të FSK-së

Selman Imeri, theksoi që ky Projektligj është kusht për liberalizimin e vizave. Gjithashtu situata në Greqi ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve për azilkërkuesit, mirëpo kjo mund të ndryshojë, sepse numri i azilkërkuesve lëviz vazhdimisht, varësisht nga rrethanat në rajon. Në bazë të një vlerësimi real ka dalur një numër prej 167 azilkërkues, të cilët janë vendosur nëpër motele të ndryshme, si pasojë e mosekzistimit të ndonjë qendre të veçantë. Ky numër kur është shumëzuar me 40 € ka dalur një kosto e madhe, mirëpo veprimet e shpejta të ministrisë kanë ndikuar që kjo kosto të ulët duke refuzuar kërkesat e azilkërkuesve dhe tani aktualisht janë vetëm 6 azilkërkues. Gjithashtu edhe Komisioni Evropian ka bërë një investim në Magure për ndërtimin e një qendre të re të azilit në vlerë prej 1.700.000 €, gjë që edhe kjo ka ndikuar në uljen e kostos.

Naser Osmani, konsideroi që disa projektligje është vështirë të cilësohen me implikime buxhetore, për shkak të rëndësisë së miratimit të këtyre ligjeve dhe nuk mund të kemi dy politika që kanë të bëjnë me kërkesa për integritet evropian. Ky është një detyrim shtetëror dhe duhet të gjendet mënyra e përballimit të kostos, pasi që kjo kosto është e lëvizshme varësisht nga situata.

Agim Krasniqi, propozoi që të aprovet Projektligji, mirëpo, për shkak të përcaktimit të vështirë të kostos së tërësisë, Ministria e Financave së bashku me Ministrinë e Punëve të Brendshme të përgatisë një deklaratë të re duke përkrahur këtë projektligj.

Latif Gashi, propozoi që ky Projektligj mos të shtyhet, por të shikohet mundësia për uljen e kostos, duke bërë ndryshime në dispozitat e projektligjit dhe të merret një vendim duke rekomanduar aprovimin e tij në Kuvend.

Kryetarja, propozoi që të miratohet ky projektligj për shkak të rëndësisë që e ka për liberalizmin e vizave, ndërsa çështja e kostos është e përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës, pasi që edhe numri i azilkërkuesve ka tendencë të rënies.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Propozim Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012

Muhamet Mustafa, theksoi që një plan veprimi duhet të jetë më konkret dhe duhet të bëhen ndryshime në cilësinë e qeverisjes makroekonomike. Propozoi që në pikën P3 të shikohet roli i forcimit të Kuvendit, pasi që seancat pyetje-përgjigje po e humbin rëndësinë e tyre. Për të përcjellur stabilitetin makroekonomik Qeveria duhet t'i ketë disa indikatorë me të cilët do të matet performanca reale. Në pikën P4, propozoi që të bëhet një plan operativ duke përcaktuar çështjet për të cilat do të organizohen dëgjime publike. Në pikën P9 propozoi që të shtohet edhe përgatitja e indikatorëve të performancës nga Komisioni për buxhet dhe Financa në bashkëpunim me ekspertë. Në pikën P35 propozoi që të shtohet edhe Komisioni për Mbikëqyerjen e Financave Publike. Në pikën P79 propozoi që të mbahet një mbledhje e veçantë me Entin e Statistikave të Kosovës për të parë se cilat janë problemet zhvillimore të këtij enti.

Latif Gashi, duke u ndërlidhur me diskutimin parafolësit që në pikën P4 të shtohet dhe hartimi i planit operativ për dëgjimet publike, theksoi se këto çështje konkretizohen në planin e veprimit të komisionit.

Hykmete Bajrami, përkrahu propozimin që në pikën P35 të shtohet edhe Komisioni për Mbikëqyerjen e Financave Publike, pasi që raportet e auditorit miratohen në atë komision dhe të krijohet që mekanizëm i përbashkët në mes të dy komisioneve, për të trajtuar çështjen e prokurimit publik në kontestin e korrupsionit.

Pas propozimeve dhe diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

Miratohen detyrat e Komisionit që dalin nga Propozim Plan i Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012, me plotësimin e pikës P4 që si fushëveprim i dytë i komisioneve përkitazi me këtë pikë, të jetë edhe “Përgatitja me kohë e planeve për dëgjimet publike” dhe plotësimi i pikës P35, ku përveç Komisionit për Buxhet dhe Financa, shtohet edhe Komisioni për Mbikëqyerjen e Financave Publike, ndërkaq në fushëveprim shtohet edhe Zyra e Auditorit Gjeneral.

7. Të ndryshme

7.1 Miratimi i Rregullores së Punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa

Kryetarja, njoftoi se Komisioni ka përfunduar shqyrtimin e Rregullores, dhe ka mbetur vetëm të votohet.

Komisioni pas votimit, njëzëri nxori këtë

Vendim

Miratohet Rregullorja e punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa

7.2 Njoftim për Projektligjin për ndryshim plotësimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike

Naser Osmani, njoftoi anëtarët e komisionit që PL për Financimin e Subjekteve Politike nuk është caktuar në rend të ditës në Komisionin për Legjislacion, pasi që ata nuk janë pajtuar me ndërhyrjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa në ligj, i cili nuk ka qenë në draft. Kjo është vetëm një çështje procedurale dhe projektligji do të procedohet drejt për në seancë në pajtim me rregullat procedurale sipas Rregullores së Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj